


BIBLIOTEKA  
8.5H-17  
C 93

IZET S. ÇULLI

# SI DHENTË NË SHTRUNGË



3


BOTIMËT TOENA

BPH-17  
CGJ

Izet S. Çulli

# Si dhentë në shtrungë

*fabula*



BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2004

IZET ÇULLI  
Neuropsikiater  
TFPELENE

**Botues: Fatmir Toçi  
Redaktor: Skënder Hasko  
Përkujdesja grafike: Elida Stafa  
Kopertina: Kosta Raka  
ISBN 99927 - 1 - 946 - X  
© Autori**

**BOTIMET TOENA**  
Rr. "Muhamet Gjollesha", K.Postare 1420, Tiranë  
Tel.: (355) (4) 240116; 240117  
Tel./Fax: (355) (4) 240117  
E-mail: [toena@toena.com.al](mailto:toena@toena.com.al); [info@toena.com.al](mailto:info@toena.com.al)  
[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

## **Arsye mbi arsyé**

- Ti, o derr, gënjen përdiell, -  
tha çakalli, - nuk jam fyell, -

kryetar partie s'doje  
ç'të shtyu të kandidoje?!

- E di pse mendja m'u kthye,  
janë njëmbëdhjetë arsyé...

- Ç'thua, çudite dynjanë,  
pa tregomë, cilat janë!

- “Një” dosa, besoj e di,  
plus nja dhjetë gicat e mi...

- Thonë s'ia ditke kimetin,  
t'u dha rasti, mile shtetin!

## Në parlament

Shpejt e shpejt, sa u hap shtrunga,  
me vrap se nuk priste puna!

Ujq, hienë, kafshë deti,  
çel sesionin parlamenti.

Kartonat i ngritën lart,  
për një ligj që ish në start.

Gjallesat syt' nga ekrani:  
- Obobo, do bëhet nami!...

Si fillim, e panë të udhës,  
të bënин ligjin e xhunglës...

## Zogu i gomarit

Kérriçi, ky zog-gomar,  
sa i bukur në të parë.

- Moj gomare, lum si ti,  
goxha visk,\* - u shpreh një dhi.

Mushka që u ndodh përballë,  
tundi kokën me ngadalë:

- I mirë the?! S'ka ku të shkojë,  
dhëntë Zoti, mos haptë gojë!...

---

\* Visk-kérriçi (krahinarizém)

## Llulla

Qeni i stanit me llullë,  
tek mjek dashi u bë pullë:

- Ti më the të rri pa pirë,  
pa shiko mos më bën mirë?

- Tani lehe si në hënëz,  
vazhdo... në s'je frytdhënës!

## Luga dhe piruni

Piruni me katër dhëmbë,  
fjalët si shtëllung'e tymit;  
Ç'qenë, i ngriti më këmbë:  
- Kap veç ajkën e ushqimit!

Luga që rrinte në qoshk  
e matur dhe fjalëpak:  
- Dëgjo, more bukuosh,  
llaftit t'i vëmë kapak!...

Mos bërtit, s'ta ha kush hakun,  
boll, ta njohim ty avazin;  
i mbushim njeriut barkun,  
ti mund t'ulthash gurmazin!

a

# Kontrast

Ariu, kokës me putër:

- Gjuhëgjati-mendjeshkurtër!

- Po, - tha tigri, - bën kontrast,  
mendjeshkurtri-gjuhëgjatë!

## Zëvendësim

- Pritëm mendje, - thotë rakia,-  
bashkë të rrimë të dyja,

sa të mbërrij në stomak,  
fill tek ti më ke pas pak!

- Mos eja, më bën kaishe  
Ç'ngele?... Veç të hyj në shishe!

|  
t

## Pilafi

Dosa zhytur nëpër llucë  
flirtonte me ca derrkucë.

Ata vinin lukuni  
dhe kjo mbante llogari.

Sa herë i hante “kurrizi”,  
në çantë një kokërr orizi...

Rrodhi puna dhe një ditë,  
orizi u bë kapicë.

Një natë tek po hanin darkë,  
foli derri: - Moj shejtankë,  
fluturon e bëhesh erë,  
mos e përdredh me të tjerë?

- Ç'i ke këto fjalë që thua?  
Ha pilaf, ç'dyshon për mua!

## Miza dhe bleta

Miza stiste muhabete,  
i vinte rrotull një blete:

- Më vjen keq për ty, e mjerë,  
këmben mjaltin me sheqer.

Mua s'ma hedh asnjeri,  
ku të dua, ha e pi.

Blet' e mirë, punëtore,  
s'e la përgjigjen pas dore:

- Jetoj dhe në majë të malit,  
ti mbete nën bisht të kalit...

## **Supa**

**Kunadhja kameriere  
shkon te dhelpa kuzhiniere:**

- Dua shtatë pjata me supë,  
m'i kërkojnë ca derrkucë.

Në tenxhere, një racion,  
skilja, sytë te një bidon...

Shpejt e shpejt edhe pa bujë,  
shtoi gjashtë garuzhde ujë.

Mbas pak pyeti djallushka:  
- Hë, thushe, si duket supka?

- Aq sa s'ke ç't'i lash' më kupës  
e pastron supa e supës...

## S'të nxë xhepi

- Lëvizje të hajthme,  
këmbët hijeshi,  
në pamje të jashtme,  
nuse për stoli.

Kangureshës zonjë  
i thoshte kanguri:  
- Je porsi lastonjë,  
qymyri më zuri.

Po ajo shpejtoi,  
sikur u bë erë,  
dhe nuk ia përtoi  
ca fjalë zeher:

- Përse rrekesh kot,  
more gjytyrim?!  
Nuk më gënjen dot,  
s'të nxë xhepi im...

## Ata janë si pendë?

Grindet derrkuci dhe keci,  
kush më mirë mbante dietë.  
Teoria në vend ngeci,  
cili kish më shumë të drejtë?

Nisi derri: - Dreq o punë,  
ujqit hanë dhen e dhi,  
dhjamin kapic' e kam unë,  
trup' i tyre për zili.


- Ç'ia këput, o derr mavria,  
dëgjo mendimet e mia:  
Ata bredhin, marrin dhenë,  
ndryshe... si do kapnin prenë?!...

Marrin kalori me mish,  
po shpenzojnë dhjetrafish.  
Ti mbete në stallë, o lumë,  
pa pushim kullufit brumë...

## Ndriçimi

Hëna po e vriste lart,  
sikur po fliste përçart:

- Ditën ti diell ndrit mirë,  
kurse unë në errësirë.
- Dale, moj përse nxitohesh,  
s'e di nga cili ndriçohesh?!



## Tagjia

Kali hamshor, i harbuar,  
sheh gomarin tē ngarkuar:

- Kështu tē pafsha gjithmonë,  
mos do pak tagji, a jonxhë?

I zgjat një grusht me tërshërë,  
për vete - torbën tē tërë...

Truri i veshos si rrallëherë,  
ja që punoi njëherë:

- Çilua ha tagji pa punë,  
kur bucelat... i ngre unë!

## Mes për mes

Me një kapistër për hunde,  
Zdruq, kërrici, si për krunde.

Ishte herët në mëngjes,  
i ra pyllit mes për mes.

Me ujqit bëri harbi  
e pagoi ky i zi.

Qan gomarica në brinjë  
me pallm' e me ulërimë:

- More bir, ç'ishte kjo gjëmë,  
do çaje detin me këmbë?!

## **Brirë dhe veshë**

Dhia shytë bishtpërpjetë:  
- Jam e mir' e me kimet!

Në pyllnajë e vetmuar,  
e hiqte veten të zgjuar...

Bregores duke u hedhur,  
kërkonte gjethe të zgjedhur.

Ujku pusinë ç'i ngriti,  
dhëmbët i nguli te fytì.

Flet kabadha: - Moj e nxirë,  
Shytkë dhe kërkove brirë!

Pa u hodh cjapi përçor:  
- La dhe veshët, kjo e gjorë!

## Halle-halle

Dreri, me tri plagë të rënda,  
rrinte shtrirë, s'i ndihej rënga.

Dhelpra kishte marrë një gjemb:  
- Le-le, le-le, sa më dhemb!

Kur e dëgjoi drenusha,  
u fry, u mbush gjer te gusha:

- Hallevogli - fjalët lumë,  
hallemadhi - hesht më shumë.

## Trajnim

Derri i huaj thatim  
shkon në stallë për trajnim...

- Më fal, – i tha një derrkuc,  
lyer-zhgërryer nëpër llucë,-

Njëzet gica kam bërë unë,  
ti, më pak apo më shumë?

- Për ç'gica flet, o trushpuar,  
nuk e di... jam i kastruar!

U hodh derri më i vjetër:  
- Po çdo nga kazaja tjetër?...

Ç'na tregoke pa kandar  
planifikim familjar!

Për kësi punësh, o trim,  
ne, kujt t'i japim mësim!

## Lemza

Drenushën, perri nga shtati,  
me një dre e lidhi fati,  
të vjetër dhe të shëmtuar.  
Ajo thosh: - Kështu qe shkruar!

Kur mori vesh drerëria,  
sa nuk plasën nga mërzia.

Bripërdredhuri një natë,  
lemzonte, nuk kish rehat:  
- Kush dreqin më zë në gojë?  
Dhe nisi të numërojë...

- Fli i qetë, mor i uruar,  
askurkush për ty, s'rri zgjuar?

- Si the? S'më kujton askush?  
Lemza kot më vjen në gushë?!

- Fare kot nuk të vjen hakut,  
Thonë: ah... zonja e shëmtakut!

## Përgjim

Për derrin në ministri,  
thoshnin është mjaft qejfli.  
Mori gickën lozonjarkë  
dhe e bëri sekretarkë.

Dosës i bënte elozhe,  
Kjo, më shumë ndjehej xheloze.  
Sa herë i shkonte në zyrë,  
montonte nga një pasqyrë.

I flet shoqja: - Ç't'u kujtua?  
- Është kryepusht... e ruaj.  
Kam frikë nga ndonjë gjëmë,  
s'e sheh, SIDA, nëpër këmbë...

Që nga lart, me reflektime,  
i zbuloj “veprat” intime.

## Maja

Ky magjari kokëshkëmb,  
dhëmbët i nguli në gjemb.

Kali briti: - Ec përpara,  
s'e sheh, na u vais barra!

Dhe e goditi në ijë,  
po veshua s'deshi t'ia dijë.

- Kot i bie, - ndërhyndushka,-  
e ka mendjen tek lëpushka...

Mos qëllo se nuk i dhemb,  
nuk ka nerva në çdo vend...

## Era

Dhelpra me shumë flamuj,  
i ngre dhe ul i ndër hunj...  
~~X~~

Të gjitha ngjyrat në duar,  
vraponte e shqetësuar.

Qesh çakalli si pérherë:  
- Me ç'duket, do kemi erë...

## Gishti

Ky ariu pijanec,  
hop e hop si karkalec.

Seç u sëmur keq zevzeku,  
shkoi për vizitë te mjeku.

- Mos pi verë dhe raki,  
dëmton rëndë në mëlçi.

- Ç'më thua, s'bëhet kjo punë,  
ku duroj pa pirë, unë?!

- Fola shqip, e do frëngjisht?  
Po fundja, të pish një gisht.

- Gishtin, që në gojë e zëmë:  
shtrirë, gjunjas a më këmbë?...

## Kush e pësoi

Pranë dashit hap pas hapi,  
një qengjush seç e la vrapin.

Lanë tufën në lëndinë  
edhe morën arratinë.

Dhelpra këto çast e pret,  
njofton ujkun me të shpejtë.

Sakaq ai erdhi pranë,  
i shqeu ata mjeranë.

Në bark kur i kullufiti,  
hiletarja këngën ngriti:

“ Si i biri dhe i ati,  
kungull e bostan rasati...”

Krism' e çiftes, vargun ~~ë~~ pret,  
të dy, me këmbë përpjetë!

## Rast i rrallë

- O sheqer, more sheqer  
uji të zhduk menjëherë.

Fliste kripa ca si hidhur,  
harroi se nga kish lindur.

Thotë sheqeri buzagaz:  
- Pa dale, mos na gajas...

Dakord, po qan hallin tim,  
ti, s'e ke këtë shqetësim?...

Më duket se ke lajthitur,  
Nuk na the diçka “të kripur”...

Fol, ti, fol qejfi s'më mbeti,  
po kujdes, se dëgjon... deti!

Andaj mos më shit të rënda,  
je pjellë që të gëlltit nëna...

## Me dredhi

- Si s'hëngrëm një drek' a darkë? -  
foli dhelpa me dredhi,-  
Që ta shtronim për merak,  
si thua, zoti ari?

- Dakord, si thua zotrote!...  
("Ta ketë me të vërtetë?")  
Hajde, ulemi qysh sonte,  
hekuri rrihet i nxeh të!

- Jo tani se... kam ca punë!...  
- E po ik, ngele skilaqe;  
ç'je e di fare mirë unë,  
je mesallë me dy faqe...

## Cinxërisht

Gjinkalla një ditë pa re,  
bleten e thirri për mend.  
Si e uli në fole,  
**T**ha: - desha mendimin tënd!

Kam një hall të madh vërtet,  
kërkoj një gjykim të thellë.-  
Cinxërakët erdhën shpejt,  
cinxërima mbushën dhenë...

Dhe bleta ashtu ngadalë  
e vështroi një dékikë:  
- Moj, s'di... mendja m'u bë dhallë,  
këta s'pushuan një çikë...

Ç'vlerësim do ti nga unë,  
ju cinxrat të hiqni trunë!...

## Syzat

Ç'e gjeti kaun mbasdite,  
iu thyen syzet optike.

Sapo pa hapur një derë,  
hyri brenda për t'i blerë.

- Më fal, -- tha delja shitare,  
nga ky mall nuk kemi fare.
- Për syza u bë kiometi?
- Zotni, është dyqan bulmeti.

## Dhurata

Macja dembele veç gjumë, s'ka kullufitur një mi,  
kur kalon anës së lumit, pa që gjuan një ari:

- Vdiqa, më sharroi barku: nga mëngjesi në mëngjes,  
të lutem, o babaxhan, më jep ca peshq, se po vdes!
- Po, - u përgjigj peshkatari, - dhe kallamin shpejt ia zgjati,-  
kjo dhuratë përmbi dhuratë, ja mësimi, ja dhe “fati”!...

## Heshtim

Dhelpra shante një sorkadhe,  
po ajo nuk ndihej fare.

Gjepuro e gjepuro,  
tjetra në vend numëro.

- Më plase, dreqi ta marrë...  
si s'më ktheve asnjë fjalë?

- Ç'më hidhesh brigje më brigje,  
pse, heshtja s'është përgjigje?!

## Zhuzħaku

Brumbulli me zhuzhurimë  
bletës “fap” i shkeli synë:

- Si thua, do vish me mua?  
Në ahur, barkun katua...

- Çdo me mua a i marrë,  
ku shkoj unë, ka vec nektar...

Ai prapë llafet i shpraz,  
vazhdonte me një avaz...

- Ik, o zhuzhak, mos na nxeh,  
rruga jote... çon në pleh!

## Humbje

Në pyll pelën humbi kali,  
e kishte gjetur gomari.

Të dy në intimitet  
po bënин një muhabet.

Shkoi çilua i nxituar:  
- S'lashë vend pa të kërkuar!

Veshoja: - Ç'ësht'e vërteta,  
ti e humbe, un' e gjeta.

Kështu e kanë këto punë,  
tani prit ta humbas unë...

## **Valiumi**

**Majmuni pa pikë talenti,  
me shkollë të lartë laneti.**

**Pyet udhës një ari:**

**- I ke parë librat e mi?**

**- I lexoj kur s'më merr gjumi,  
më të mira se Valiumi...**

## Borxhemadhi

*si i tērbaar,*

Me një pallmë ~~qasus qasus~~,

tha kërriçi një mëngjes:

- Ta dëgjojë kush s'ka dëgjuar,  
do marr hua pér biznes!

- Rri rehat, ec me ngadalë,  
i foli një kal i mirë,  
se ësht' lehtë të hysh në valle,  
por, të dalësh... e vështirë!

## Një Këshillë

Një majmun kock' e lëkurë  
s'ndihej mirë me shëndet.  
I tha mjekja: - Je sëmurë,  
keq më vjen, ke Diabet!

Gorilla shum' e menduar  
i dha një dietë të prerë:  
- Nuk mëtoj për ta shëruar,  
po, kontroll do bëjë pérherë...

Kujdes dhe ti majmuneshë,  
ky i gjorë s'duhet të vuaj,  
një gjë parasysh ta keshë,  
“gjumë të ëmbël” mos i thuaj!

## Zgjebosje

Cjapi me kokën përpjetë:  
Tha: - shikoni, rroj si mbret!

- Po ç'mbretziu, - qeshi dhia,  
ty të mungojnë të dyja,  
pasuria edhe mendja,  
ç'bie jashtë, bie brenda!...

Ma mban kokën lart nga lisi,  
mbushur me këpush' kurrizi!...  
Pa më rri dhe i krekosur,  
hundëlart e i zgjebosur!...

## **Qepa dhe hudhra**

**Qep' e hudhër pos i motra  
asnjëherë mos t'u hamë hakun,  
po një ditë bënин lodra,  
kush e djeg më shum' stomakun.**

- Ti hudhër, ke një të metë,  
s'ta kam thënë tjetër herë,  
besoj e kupton dhe vetë,  
sa tërbon me atë erë?

- Qepë, mos t'a kesh vështirë,  
ka më keq në këtë botë,  
një gjë duhet t'a dish mirë,  
prej teje... kush nuk derdh lot?!

## Cigarja

Derr e dosë në korie  
me sinjale dashurie:

- Ku je moj, zemërbehare,  
do pimë bashk' një cigare?

Tjetra sikur s'ish gjékundi,  
po pas pak, kokën e tundi.

Dhe derrickut, koka erë,  
u bë gati menjëherë.

Po dosa shpejt u pendua,  
fët dërrkuci: - S'më do mua?

- Keq më vjen, je rrot' kandari,  
thamë cigar', jo bishtcigari...

## Biznes

Maçoku qysh në mëngjes:

- Mackë, do filloj biznes.

Jam i aftë s'ka si unë,  
ndaj do bëjmë pare shumë.

- Ua, i dashur ç'më gëzove,  
oh, sa shpejt na pasurove...

Kot më mburresh more maç,  
s'më ha buza për kulaç...

## Marrëzisht

Dergjej kali në ahur,  
Kish ca ditë që ish sëmurë.

Gomari pëlliste kot,  
çilua s'e dëgjonte dot.

Po i lutej disa herë:  
- Dil jasht' e pëllit më derë!

Po gjajdhuli, si gjajdhul,  
si nxë koka, e ka tul.

S'kish ç't'i bënte më doriu,  
thellë në shpirt psherëtiu:

- Sëmundja godet shëndetin,  
më keq ësht' për ty, të shkretin...

Janë mosgjë hallet e mia,  
kur të godet marrëzia.

## Dhjetëvjeçare

Shkon ariu në banak  
dhe trokiti tak-tak-tak.  
Donte verë dhjetvjeçare,  
Dhe të mirë dhe me pak pare.

Luanesha banakiere:  
- Hidhu, ose dil prej dere!...  
Të isha kaq dorëlëshuar  
s'do kish verë të staxhionuar.

## Xanxarja

Një mushkë grivë, xanxare,  
me shkelma, nuk mbahej fare.  
Pela, kuaj dhe gomarë,  
i ngacmonte si ~~f~~ marrë.  
*e*

Më në fund atë e ndanë,  
asnjë nuk i rrinte pranë.  
Ajo nga mendja sëmurë  
dhe vetëm... zihej me gurë.

- Sa çudi, - u shpreh një kalë,-  
kjo na qenka rac' e rrallë...  
Si oktapodh... E vërteta,  
sa ha dhe këmbët e veta!

## Mësimi

Pallmëronte lop' e çmendur,  
ngacmonte shoqen e mençur:

- Ti je kot, s'ta pret fiqiri,  
të rruat gjiri dhe briri...  
S'e njeh pallmën, rri e heshtur,  
s'ndihesh fare, si e mekur.

- Ç'të të flas, kur ti s'nxe më,  
truri rrafsh nuk mban asgjë...  
Ndërsa unë, moj zemra ime,  
dhe prej teje nxjerr mësime.

## Kur s'do t'ia dish...

Një dit' të bukur për diell,  
cjapi me mendjen si fyell,  
nëpër pyll shkon me vërvimë,  
s'pyet për ujq e angullimë...

Foli dhia shkurt dhe prerë:  
- Si na iku... u bë erë?!

Ujku i uritur shumë,  
sa e pa mbaroi punë.  
U hap lajmi, rrugët merr,  
dhi e larme pa partner...

- S'më dëgjoi, m'u largua,  
shkon për gozhd' e le potku...

## Gënjeshtra me bisht

Një çakall në shpellinë  
e kish të madhe urinë.

Priste dhelprën deri vonë,  
t'i sillte një qengj të njomë.

Pyet baldosa e habitur:  
- Ç'pret këtu si i zalisur?

- Skilja më premtoi mbrëmë,  
do më sjellë për të ngrënë.

- S'e njeh atë bishtpërdredhur?  
Sa bukur ta paska hedhur.  
Kur premton shkruan në ujë,  
po ngrehu, gjej ndonjë ftujë!

## Trimoshi

Miushi mustaqegjatë  
kokën seç e mbante lart.

I dukej hunda dyfek:  
- Trim i trimave jam vetë!

Te qoshja macja u duk,  
Miu në një vrimë u struk.

Kur e pa qeshi patoku:  
- Frikalec, s'i gjendet shoku!

Shikoni ç'ia paska mbathur,  
nga trimosh, fishek i lagur...

## Provimi

Jepte provim një kërriç,  
përgjigjes s'ia shkrepte hiç.

E kur doli me vërvimë,  
**shkoi u hodh në pishinë.**

Një lëvrek laraman,  
u afrua aty pranë:

- Hë, si dole, more vesk?
- Hyra mish e dola peshk...

## Nën buzë

Buzëqeshja nën mustaqe,  
tha, kur pa lotin në faqe:

- Pika lot, që bën hatanë  
hidhëron gjithë dynjanë!

Loti tha me psherëtimë:  
- E di që e lag shaminë...

Po ti je më keq se unë,  
shpesh na i derdh lotët lumë!

## Bashkëjetesë

E vërteta tha njëherë:

- Ti dhembje të mbin në derë!

- Kështu e kan' këto punë,  
rruga jote shkon nga unë...

## Koha

Hapësira mendjegjerë:

- E pushtoj botën të tërë!...

Ti kohë shkon fluturim,  
gjithnjë me shumë nxitim.

S'e di, ç'bën në këtë botë,  
vërdallisesh kot më kot.

- S'iki kot e në hava,  
mbuloj e zbuloj gjithçka!

## **Qesëndisje**

**Lart e vriste dash llajushi,  
me profka vendin e mbushi.**

**Që të dukej më i zgjuar:  
- Do ta lë mjekrën pa rruar!**

**E quesëndis delja bejkë:  
- Mor qyqan, ç'je kaq i lehtë...**

**Mjekër mban dhe një cjapok,  
po nga mendja është trokë...**

## Dera dhe brima

- Kur më hapin, hyn pranvera,  
se s'jam birë, - thoshte dera.
- Dale, nuk më tall dot sheshit -  
kërcen lart vrim' e çelësit, -  
  
nga ty duket krejt mëhallat,  
tek unë sheh... pamje të rralla...

## Zgjimi

Gjeli përmbi pleh, tek rri,  
na çmeriti ki-ki-ki:

- S'jam si ju, more të mjerë,  
në mëngjes çohem më herët!

- Po pusho, - u nxeh një kulloçkë, -  
këto nuk i han' as zogjtë...

O këndes, të humbtë vula,  
ngrihesh në një koh' me pula,

veç ndryshon, more lafshprerë,  
kur zgjohesh, njofton të tjerë!...

## Të paftruara

Mushicë\*, - tha një sorkadhe, -  
ç'është kjo bela e madhe!...  
Dhe mushkonja mbi kurriz  
më keq po më helmatis!

- Po mirë, ti nuk e ditke,  
veç sa të lëpij, moj mike...  
Ç'ankohesh nga un', o bojë,  
ka të tjerë me thumb në gojë!

---

\*Mushicë – mizë e vogël

## Guva

Dashi bashkë me një milore,  
të kapur dorë për dore,  
zgjodhën një lokal për mbret  
me mbishkrimin “Guva e qetë”.

Rudaku doli në derë,  
pa reklamën dhe njëherë:

-Ç'guv' e qetë, dreqi e mori,  
gërr-gërr-gërr gjeneratori!

---

\* Milore – qengj femër gjer në dy vjeç

## Nënvierësim

Bushtra doli lart nga mali,  
lajkatonte një qen stani.

Balos ia bëri me kokë,  
Ngeli kopeja pa zot...

Ujku që vërtitej rrötull,  
ra në tuf' e s'gjen të ngopur.

Delja rud' që kish shpëtuar  
e zuri kokën me duar:

- Qeni bredhëron e krihet,  
se kush e paguan, dihet.

## Mëshirë

- Ik nga vatha, diku struku,-  
i flet nga larg qenit, ujku-

s'më le aspak hapësirë,  
për mua s'paske mëshirë?

- Çdo lëshim për ty, o horr,  
gjëmë për qengjat e gjorë!

## Premtimelumi

Donte votat një ari,  
ngjallte shpresa, si ai.

Në miting kafshët e gjora  
nga e keqja, ia bënë fora:

- Rroftë ariu! Lart ariu!  
leпури, dreri dhe thiu.

Mërmëriti një sorkadhe:  
- Po ky, nuk besohet fare!...

Me premtimet kaq i thekur,  
më kujtoi një të vdekur.

Fjalët e mira sa sosin,  
menjëherë e varrosin!

Kur zotohesh si kolos,  
sa kthen krahët, i gropos...

## Hidh e prit

Vërr, vërr gënjeshtra furtunë:

- Kur vjen kjo, unë mbaroj punë...

Me shikim nga unë ngrijnë,

ti e vërtetë të vret synë!

Nunisi tjetra nën buzë:

- E di, e di, që je shpuzë...

Ti s'vret, po u <sup>ç</sup>ngjeth mishin,  
vonoj ca... po shëroj shpirtin!

## Pegasi

Kur u ngrit në orë mësimi,  
pyeti cjanin karçini\*:

- Më lejo, zoti mësues,  
ç'ësht' Pegasi fluturues?

Ta shpjegoj ngaqë s'e ditke,  
kal' i muzës poetike,

yllësi mbi mal e fushë,  
një hyjni, mor vogëlush.

- Po mirë... ju jeni poet,  
s'fluturoni, për kaq vjet?!

- Ke të drejtë, po ti s'e di,  
Pegasi kërkon... “tagji”!

---

\*Karçin – kec i sakëputur nga e ëma; ftujak, motak

## Një dialog i vjetër

Papunësia: - Moj punë,  
ku je ti e ku jam unë!...

S'e mundoj fare njerinë,  
ndërsa ti i merr lirinë.

- Vërtet i heq pak liri,  
po ç'i jap, vallë, e di?...

Unë gjithçka të mirë u sjell,  
krim e dembeli ti mbjell.

## **Monovratori**

**Doli kali në pazar,  
për të shitur një gomar.**

**Kau plak që ndihej rëndë  
desh ta blente për parmendë.**

**Tha çilashi: - Sa i shpejtë,  
e çoi në tatëpjetë.**

**- Po nga frenat, manovrimi,  
fët kau, - i do lërimi!**

**- Për këto e ke të rrallë,  
di të eci dhe ngadalë...**

**Paçka se s'dinte një fije  
një ngadalje shpejtësie.**

**Tërheq magjarin për dore,  
e çon për prov' në malore.**

**Do a s'do veshua i shkretë,  
nxitimin e uli vetë...**

## Mosplakje

Mjek luani me qeti  
këshillonte një ari:

- Të kam thënë disa herë  
të mos pish më alkool,  
po ti mendjen e ke erë,  
pse s'dëgjon, ore kaqol?!
- O doktor, e di pse pi?  
Më jep forcë, më mban të ri.
- Ç'po më lodh, o kokëgur!  
Vërtet, nuk do plakesh kurrë...

## **Nervafryrë**

Demi kish varur turinë,  
Dhe me shkelm derdhi kusinë.

- Ç'bën more? - palli lopa -  
ç'lodhem kot, s'të kuhton koka?!...

Kur sheh qumështin, e menduar,  
diç foli Lara syshkruar:

- S'e kuptoj, pse nxehet kot,  
sa për nerva s'paske shok?!

Qumështi dhe demi vetë,  
në të nxeh të fryhen lehtë...

## **Pa faj**

**Bukuria e krekosur:**

- **Mbas meje si t  marrosur!...**  
**Dituri, s't  kan' d shir ,**  
**ndaj s't  shohin me t  mir .**

**Dija ndenji e menduar,**  
**pastaj i tha shtruar-shtruar:**

- **Ashtu ndodh, po s'kam faj un ,**  
**ndaj ka injorant' kaq shum ...**

## Plikoja dhe telegrami

Plikos, mbushur plotpërplot,  
telegrami diç i thotë:  
- Nga jashtë na dukesh spicë,  
po ç'e do ke barkun bic!...

- Pse më nget, ore zevzek,  
ti i shet llafet me lekë?...  
Matem nga veprat, nga barra,  
ty të numërohet fjala...

## **Shosha**

**Papagalli këtë herë  
goxha post, në dikaster.**

**Ç'barrë që mori mbi vete  
i besuan kaq sekrete!**

**- “E ndreqën”, - tha një kaposh-  
zunë diellin me shoshë...**

## Ndryshimi

Vjen urrejtja me furtunë:

- Dashuri, sa larg jam unë!

- Jo, moj jo, kaq tutje s'jemi  
një dallim të vockël kemi:

në fillim nga e mbjella,  
në fund ndryshojmë nga pjella...

Ti e nxin, un' e zbardh faqen,  
na fal luftën, dhuroj paqen!

## Në shtrungë

- Çudi, - foli një langua, -  
këta m'a shkuan dhe mua!

Para zgjedhjesh mbin' në derë,  
dyzet parti menjëherë...

Na e lypin pa të keq  
Po, mor, po votën, për dreq...

Një bushtër andej nga fundi,  
si rrallëher' mexhlisin tundi:

- Si dhentë në shtrung' na vunë,  
kujt t'ia jap, një vot' kam unë...

## Letra

Vërvëlîste papagalli:

- Mor urith, tê marrtë djalli,  
më rri i strukur ngaherë,  
po kur del zhdukesh si erë.
- Unë vërtet ngado rrëmih,  
po s'ndaj letra pér tê gjithë...

## Në farmaci

(Sipas Frederiko Major)

Vjen derri gjinekolog,  
drejt tek dreri patolog:

- Kontraceptivët, e di,  
shiten në kinkaleri.

S'ka nevojë për “recetë”,  
kush t'i dojë, ti blejë vetë.

- Jam dakord, s'kam kundërshtim,  
po kam vec një sugjerim:

Duhet futur, gjithsesi,  
duhani në farmaci.

## Frikësim

Sekretari, një gomiç:<sup>\*</sup>

- Para meje, të gjith' hiç!

Plas kali, u hakërrye:

- Po ke kryetar mbi krye!...

- Në do ta them ashqare,  
atë nuk e pyes fare...

- Ç'gjepuron, more avdall,  
na e bëre mendjen dhallë!

E di një kuriozitet?  
Edhe elefanti mbret,

le të jet' i fortë, hekur,  
por trembet dhe nga një lepur...

---

\*Gomiç - gomar (emër zvogëlues dhe përqmues i tij)

## Deriçka

Në partin' e tyre derrat,  
zihen, grinden si skifterat.

Oh, sa shumë debate bosh,  
teprojnë edhe për kosh...

S'bien poshtë' rugjot e vjetër,  
hyjnë në partinë tjetër...

Deputetin s'e lënë kurrë,  
mbir' në çdo legjislaturë.

Dhe ndonjë që lëshon vicka,  
del në der', hyn nga deriçka...

- Janë kaluar, - thotë kali-  
mjerë ne, na mbyti halli!

## **Kallaji**

**Derri shef në ministri  
kur qëllon ditë me shi,**

**me të zbritur nga makina  
e rrëthon grupi me “trima”...**

**Hapin çadrën menjëherë  
nuk lënë një pikë t'i bjerë.**

**Flet dashi: - Vendi s'ju zë,  
s'është sheqer, ç'kini me të?!**

**Hop cjapi: “Rudak vëllai,  
ruhet se i del “kallai”...**

## **Druri dhe tymi**

**Zgjatu, zgjatu qiparisi  
gjer në re, qiellin grisi.**

**- Po ti more çdo këtu?  
Pemë pa kokrra, qenke dru.**

**- Eh, moj re, t'a dish dhe ti,  
tym të thon', po s'hodhe shi...**

## Pleħu

Grimc' e vogël diamant  
ngacmoi kokrrën nitrat:

- Je i bardħë, po quhesh pleħ,  
ta them troç, mos u nxeh!
- Jo, nuk nxehem asnječ cikċe  
e the mirę, i vure pikċe.

Nga ty s'lind gjie, asnjeħer,  
prej meje - lulet me erie...

## Lypsari

Gorilla, dembele me brirë,  
për të lypur del pa gdhirë.  
Me dy qindarka ndër duar,  
nuk linte vend pa kërkuar.

Në shi, diell, a dëborë  
shtrir' i mbeti njëra dorë:

- Të faltë Zoti, fal dy lekë,  
s'kam ç'të ha mëngjes e drekë!

Zebra s'e duroi gjatë  
dhe iu kthyesh me inat:

- Pse s'shkon të kryesh një punë,  
nuk do lodheshe kaq shumë...

Rron me djers' dhe milingona,  
ti rri, pret lëmoshat tonë!....

## Hall përmby hall

- O kunadh, - tha një kunadhe,  
paskam lindur hallemadhe.

Në të majtë kur shtrihem unë,  
më dhemb zemra, oh, sa shumë!

Edhe djathtas, sëkëlldia,  
si gjilpër'më shpon mëlçia.

Sa herë që fle përbys,  
ndiej lodhje në kurri.

Më keq kur kthehem në shpinë,  
më godet brinjë më brinjë.

- Paske hall e përmby hall,  
s'ngelet, veç të flesh, si kalë...

## Njollat

Këndesi vrapin te shkolla,  
tërë baltë e njolla-njolla.

Kunadhja iu qep nga prapa,  
ai ngjitet te lofata.

- Zbrit, pastrohu, mos ki frikë  
se të tall edhe një rikë!\*

- Këto pikla, mor besëprerë  
i heq uji menjëherë.

Kur i ke njollat në shpirt,  
nu~~k~~i lajnë as perënditë...

---

\* Rikë – zog rose, bibë rose

## Fjongoja

Ç'tallje mbrujtën dy patokë:

- Pa shikon, ky ka kokë!...

Lum, o gjel me atë lafshë,

sa i mençur je, më qafsh!

Kur ia merr këngës mbi pleh,

ia shkon qenit, që kot leh...

U kënaq shumë këndesi,

vrapin mbajti te qymezi.

Një fjongo lidhi mbi krye,

për ta parë shpejt u kthye.

Nënqesh pula lart te muri:

- Tani po, vulën e vuri...

Ç'gënjen mendjen, mor i mjerë,

koka jote është djerrë...

# Përbajtja e lëndës

Arsye mbi arsyе .....	3
Në parlament .....	4
Zogu i gomarit .....	5
Llulla .....	6
Luga dhe piruni .....	7
Kontrast .....	8
Zëvendësim .....	9
Pilafi .....	10
Miza dhe bleta .....	11
Supa .....	12
S'të nxë xhepi .....	13
Ata janë si pendë? .....	14
Ndriçimi .....	15
Tagjia .....	16
Mes për mes .....	17
Brirë dhe veshë .....	18
Halle-halle .....	19
Trajnim .....	20
Lemza .....	21
Përgjim .....	22
Maja .....	23
Era .....	24
Gishti .....	25
Kush e pësoi .....	26
Rast i rrallë .....	27
Me dredhi .....	28
Cinxërisht .....	29
Syzat .....	30

Dhurata .....	31
Heshtim .....	32
Zhuzhaku .....	33
Humbje .....	34
Valumi .....	35
Borxhemadhi .....	36
Një këshillë .....	37
Zgjebosje .....	38
Qepa dhe hudhra .....	39
Cigarja .....	40
Biznes .....	41
Marrëzisht .....	42
Dhjetëvjeçare .....	43
Xanxarja .....	44
Mësimi .....	45
Kur s'do t'ia dish... .....	46
Gënjeshta me bisht .....	47
Trimoshi .....	48
Provimi .....	49
Nën buzë .....	50
Bashkëjetesë .....	51
Koha .....	52
Qesëndisje .....	53
Dera dhe brima .....	54
Zgjimi .....	55
Të paftuara .....	56
Guva .....	57
Nënvlerësim .....	58
Mëshirë .....	59
Premtimelumi .....	60
Hidh e prit .....	61
Pegasi .....	62
Një dialog i vjetër .....	63
Monovratori .....	64
Mosplakje .....	65
Nervafryrë .....	66

Pa faj .....	67
Plikoja dhe telegrami .....	68
Shosha .....	69
Ndryshimi .....	70
Në shtrungë .....	71
Letra .....	72
Në farmaci .....	73
Frikësim .....	74
Deriçka .....	75
Kallaji .....	76
Druri dhe tymi .....	77
Plehu .....	78
Lypsari .....	79
Hall përmbi hall .....	80
Njollat .....	81
Fjongoja .....	82

CIP. Katalogimi në botim - B.K. Tiranë

Çulli, Izet

Si dhentë në shtrungë : fabula / Izet Çulli ;  
Red. Skënder Hasko. - Tiranë : Toena, 2004  
88 f. ; 20 cm.

ISBN 99927 1946 X

821.18-191

Formati: 14x20 cm

Shtypur në Shtypshkronjën TOENA

Tel: (355) (4) 358 539

Tiranë, 2004

**Izet S. Çulli** prej shumë vitesh shkruan letërsi artistike për fëmijë e të rritur në disa gjini si edhe publicistikë. Po ashtu ka botuar edhe **5 libra nga fusha e mjekësisë, shkencore-popullore.**

**Fëmijëve u ka dhënë 6 libra me poezi, poema, përralla (*njerin prej tyre, me poezi të zgjedhura, e ka publikuar në Kosovë, duke ua dhuruar atyre*).**

### **Librat për të rritur titullohen:**

1. “Loti i pulëbardhës” (*poezi dhe prozë e shkurtër*), Tiranë, 1997
2. “Stina e çudirave” (*epigrame, mikrokomedi*), Tiranë, 1998
3. “Bijtë e zonjës mëmë” (*poezi përkushtim*), Tiranë 1999
4. “Dielli i atdheut” (*poezi*), Tiranë, 2001
5. “Zemrën ti ma gatove...” (*skica, ese, publicistikë etj.*), Tiranë, 2003
6. “Fajin nuk e ka pasqyra” (*skica dhe tregime*), Tiranë, 2003
7. “Buzëqesh hidhur” (*epigrame, fabula, poezi humoristike*),  
Tiranë, 2003
8. “Shumë dhelpra paska jetë!” (*fabula*), Përmet, 2003

Është fitues i çmimit “Tasim Gjokutaj” me librin “Në krahët e jetës” (“Toena, 2000) dhe është vlerësuar me çmimin e parë për prozën humoristike me botimin “Fajin nuk e ka pasqyra” (“Pegas”, 2003).

**Merr pjesë në disa shoqata krijuesish dhe në kolegjumin e katër gazetave.**



Çmimi: 250 lekë (2,00 €)

ISBN 99927 946 X  
BOTIMET TOENA